



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenin 2, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligji nr. 03/l-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/l-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 05/l-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe dëgjimit publik brenda afatit ligjor, nxjerr këtë:

VENDIM PRELIMINAR

- 1. Miratohet** shpronësimi për interesin publik i pronës së paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, e cila ndodhet në zonën kadastrale: Gjakovë Jashtë Qytet, me nr. Parcelës 4375-7, e cila përfshihet nga projekti “Ndërtimi i Rrugës Kolë Lleshi” në Gjakovë, sipas tabelarit i cili i është bashkangjitur këtij Vendimi.
- 2.** Pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës, njoftohen pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen.
- 3.** Palët kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda (30) tridhjetë ditëve kalendarik në Gjykatën kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronarë ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
- 4.** Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Gjakovës.
- 5.** Vendimi hynë në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Infrastrukturë
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronë
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
SKUPSTINA OPSTINE DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. Rendor	Nr. Parceles	Pronari	Kultura	Sip. Totale	Sip. për shpronësim	Sip. E mbetur	Zona Kadastrale
1	4375-7	1/1 Art Building SH.P.K.	Jopjellore	906	795	111	Gjakove Jashte Qytet

